

# BULETIN MUJOR



## Matura Shtetërore 2026, ministrja Kumbaro prezanton rregullat për maturantët

Mbi 2000 mësues dhe 170 monitorues në 144 qendra provimi do të jenë përgjegjës për mbarëvajtjen e Maturës Shtetërore 2026. Maturantët duhet të paraqiten në ambientet e shkollës në orën 08:30, ndërsa provimi do të nisë në orën 10:00. Nxënësit duhet të kenë me vete mjet identifikimi, kartë ID ose pasaportë, dy stilolapsa, një vizore të vogël e makinë llogaritëse të thjeshtë. Rregullorja parashikon ndalimin e rreptë të përdorimit të telefonave celularë dhe orëve smart gjatë provimit. Po sipas rregullores, largimi nga provimi do të bëhet në orën 12:30 për të gjithë nxënësit.



## Programi "Pas Shkollë" pilotohet në 47 shkolla

Ka nisur pilotimi i programit "Pas Shkollë" në 47 shkolla, 45 në Tiranë dhe 2 në Kamëz. Ministria e Arsimit nëpërmjet edukimit 'Pas Shkollë' synon përmirësimin dhe unifikimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare në shkolla. Ky program ka për qëllim jo vetëm zgjatjen e qëndrimit të nxënësve në shkollë, por krijimin e një mjedisi të sigurt dhe frymëzues, ku ata mund të zhvillojnë edhe talentet. Në Tiranë, në 45 shkollat ku po pilotohet programi, janë 308 mësues të angazhuar dhe rreth 4500 nxënës. Në 2 shkollat e Kamzës janë 17 mësues të përfshirë dhe 240 nxënës.



## Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore

U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore mes Ministrisë së Arsimit dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF). Kjo marrëveshje synon të transformojë institucionin përgjegjës për administrimin e provimeve kombëtare dhe shërbimeve të tjera kyçe arsimore në një institucion modern, autonom dhe të bazuar në standarde ndërkombëtare. Marrëveshja hap një fazë të re bashkëpunimi, ku ekspertiza ndërkombëtare do të ndihmojë në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe optimizimin e proceseve, duke rritur besueshmërinë dhe cilësinë e sistemit të vlerësimit.



## Provimi i VANAF, testohen mbi 27 mijë nxënës të klasave të pesta

Eshtë zhvilluar testimi për Vlerësimin e Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor, i njohur si VANAF, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta. Testimi vlerësoi njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara gjatë ciklit fillor të 27 mijë nxënësve në tri lëndët kryesore: Gjuhë Shqipe, Matematikë dhe Dituri Natyre të hartuara sipas programit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. Ky testim u shërben edhe institucioneve për orientimin e politikave arsimore me folkus rritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar.



## Finalet e Edicionit të katërt të Ekipeve Sportive në Shkolla

U zhvilluan ndeshjet finale të edicionit të katërt të Ekipeve Sportive në Shkolla me pjesëmarrjen e 10 mijë nxënësve në gjithë Shqipërinë. Për herë të parë këtë vit, programit iu shtua edhe disiplina e shahut, me pjesëmarrjen e mbi 650 nxënësve. Nga ky aktivitet, ministrja e Arsimit Mirela Kumbaro bëri të ditur se në edicionin e pestë do të ulet mosha e fëmijëve pjesëmarrës dhe do të shtohen edhe disiplina të tjera sportive.



## Ministrja Kumbaro takime në Austri me fokus arsimin e lartë dhe partneritetin me Universitetin BOKU

Gjatë një vizite pune në Austri, ministrja e Arsimit Mirela Kumbaro zhvilloi një seri takimesh me përfaqësues të institucioneve austriake të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, të fokusuara në procesin e rishikimit të ligjit të arsimit të lartë në Shqipëri, si edhe në forcimin e bashkëpunimit akademik mes dy vendeve. Po në kuadër të kësaj vizite, ministrja Mirela Kumbaro së bashku me drejtues të Universitetit Bujqësor të Tiranës, zhvilluan një mision studimor në Universitetin BOKU në Vjenë, institucion i njohur për bashkëpunimin e tij të suksesshëm me Universitetin Bujqësor të Tiranës.